

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR MIRATIMIN E SHITESËS SË KONTRATËS SË KONCESIONIT TË FORMËS “BOT” (NDËRTIM, SHFRYTËZIM DHE TRANSFERIM) TË NJË PORTI TË LLOJIT MBM NË PORTO-ROMANO, DURRËS, MIRATUAR ME LIGJIN NR.104/2015, NDËRMJET MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË DHE SHOQËRISË KONCESIONARE “PORTI MBM (MULTY BUOY MOORING)” TË NDRYSHUAR”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Ky projektligj ka si qëllim dhe objekt miratimin e shtesës së kontratës së koncesionit të formës “BOT”, të nënshkruar në datë 21.7.2015, dhe të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me ligjin nr.104/2015, “Për miratimin e kontratës së koncesionit të formës “BOT” (ndërtim, shfrytëzim dhe transferim) të një porti të llojit MBM në Porto-Romano, Durrës, ndërmjet Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës dhe shoqërisë koncesionare “Porti MBM (Multy Buoy Mooring)” dhe të ndryshuar me ligjin nr.13/2018.

Shoqëria Porti MBM ka paraqitur kërkesë në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për ndryshime në kontratën koncesionare. Qëllimi i kësaj kërkesë është krijimi i kushteve nga autoriteti kontraktor që koncesionari të shfrytëzojë maksimalisht kapacitetet e portit, ndryshime të cilat nuk do të kenë efekte financiare për buxhetin e shtetit, përkundrazi ndryshimet do të ndikojnë në rritjen e të ardhurave që do të depozitohen nga shoqëria koncesionare në buxhetin e shtetit nëpërmjet *Fee*-së koncesionare. Ndryshimet e propozuara nuk kanë si qëllim ndryshimin e kushteve të tjera thelbësore të kontratës koncesionare.

Objektivat që synohet të arrihen nëpërmjet këtij projektligji janë, si më poshtë vijon:

1. Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve nga koncesionari në zbatim të kontratës koncesionare të miratuar me ligjin nr.104/2015, i ndryshuar;
2. Marrja e masave për parandalimin e ndotjeve detare gjatë operacioneve të ngarkim-shkarkimit të mjeteve lundruese;
3. Marrja e masave për operimin e sigurt të mjeteve lundruese brenda territorit të portit;

4. Rritjen e të ardhurave që do të depozitohen në buxhetin e shtetit nëpërmjet mbledhjes së tarifës së *Fee*-së koncesionare në zbatim të nenit 13, të kontratës koncesionare.

Nga ana e autoritetit kontraktues u shqyrtua kërkesa e shoqërisë koncesionare, e cila u vlerësua e argumentuar, me synim përmirësimin e shërbimeve të ofruara gjë që sjell dhe përmirësimin, rregullime të situatës reale në terren.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektligj është në përputhje të plotë me politikën e Këshillit të Ministrave për zhvillimin e kapaciteteve depozituese portuale, rritjen e transparencës si dhe të bashkëpunimit me biznesin.

Gjithashtu, ky projektligj është në përputhje të plotë me Strategjinë Sektoriale të Transportit dhe të planit të veprimit 2016-2020, ku në prioritetin strategjik 2 “Rritja e qëndrueshme për tregjet detare dhe portuale” objektivi 2.1 “Rehabilitimi dhe modernizimi i infrastrukturës dhe shërbimeve portuale”, është parashikuar në pikën 3, nëpërmjet përmirësimit të infrastrukturës së koncesionit Porti MBM.

Ky projektligj nuk është parashikuar në programin e përgjithshëm analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave, gjatë vitit 2020.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Shoqëria koncesionare “Porti MBM (Multy Buoy Mooring)”, me shkresën nr.24/01 prot., datë 24.2.2020, ka paraqitur propozimin për shtesë në kontratën e koncesionit, të miratuar me ligjin nr.104/2015, të ndryshuar me ligjin nr.13/2018.

Shkurtimisht kërkesa e shoqërisë koncesionare bazohet në shfrytëzimin maksimal të kapaciteteve të portit, përmirësimin e shërbimeve të ofruara gjë që sjell dhe përmirësimin dhe rregullime të situatës reale në terren të portit, të cilat reflektohen dhe në përmirësimin të aneksit 1/1, të kontratës së koncesionit të ndryshuar.

Në shkresën e shoqërisë koncesionare “Porti MBM (Multy Buoy Mooring)”, për ndryshime të kontratës koncesionare të ndryshuar dhe konkretisht shtesë në nenin 3 të saj, duke qenë se aktualisht Porti MBM ka kapacitete të mjaftueshme

të akuatoriumit dhe akostuese si në terminalin verior ku përpunohen mjetet lundruese që transportojnë hidrokarbure ashtu edhe në argjinaturën jugore, shoqëria koncesionare kërkoi nga autoriteti kontraktor që në argjinaturën jugore të përpunojë mjete lundruese që transportojnë mallra. Kjo do të sillte shfrytëzimin e plotë të kapaciteteve të portit dhe do të ofronte një shërbim më të specializuar për klientët, më të pastër dhe me kosto më të ulët.

Sipas aneksit 1.1, të paraqitur nga shoqëria, janë pasqyruar rregullime të situatës reale në terren dhe, konkretisht, te pjesa e dytë është përcaktuar që te koordinatat e paraqitura ndodhet salla e kontrollit të distributorit shpërndarës. Referuar sipërfaqes së operacioneve në tokë për përmirësimin e shërbimeve të kryera në të, në aneksin 1.1, janë reflektuar të dhënat përkatëse për sipërfaqen e shfrytëzuar si dhe vendndodhja e kalatave ku do të akostohen dhe përpunohen mjetet lundruese. Në pjesën e tretë dhe të katërt të aneksit 1.1, janë përcaktuar dhe koordinatat gjeografike të argjinaturave përkatëse.

Po ashtu, shoqëria koncesionare në kërkesën e saj si dhe në të gjitha komunikimet gjatë negociimit të shtesës së kontratës, ka mbajtur qëndrimin se shtesa ka qëllim të vetëm shfrytëzimin maksimal të kapaciteteve të portit përmirësimin e shërbimeve ndaj klienteve, mbrojtjen e mjedisit detar nga ndotja, forcimin e sigurisë dhe zhvillimin e mëtejshëm të zonës së Porto-Romanos e cila së shpejti do të jetë zonë e lirë doganore.

Për sa më sipër, kërkesa e shoqërisë koncesionare për shtesë të kontratës koncesionare parashikohet dhe në ligjin e posaçëm të koncesionave dhe partneritetit publik, ligji nr.125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar. Në nenin 31, të këtij ligji, “Ndryshimi i kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat”, parashikohet se:

- “1. Kontratat e parashikuara me këtë ligj mund të ndryshohen duke i shtuar kontratës një aneks, me kusht që kjo mundësi të parashikohet në dokumentacionin e tenderit dhe në kontratë.
2. Ndryshimet në kontratë bëhen nga autoriteti kontraktues dhe koncesionari /partneri privat.
3. Ndryshimet në kontratë mund të bëhen me iniciativën e të dyja palëve kontraktuese veçanërisht në rastet e mëposhtme:
 - a) kur rrezikohet siguria kombëtare dhe mbrojtja e vendit, rrezikohet mjedisi, natyra dhe shëndeti i njerëzve;
 - b) kur humbet objekti i kontratës ose kur ekziston një pamundësi objektive për përdorimin e tij, në rastin e forcës madhore;
 - c) gjatë ndryshimit të kuadrit ligjor;
 - ç) në raste të tjera që çojnë në ndryshimin e situatës reale ose ligjore për përdorimin e objektit apo ofrimin e shërbimeve, ose në realizimin e kontratës.”.

Në vlerësim të kuadrit ligjor të këtij koncesioni, si dhe propozimit të bërë nga shoqëria koncesionare, u gjet e argumentuar kërkesa e shoqërisë, që kërkon plotësimin e ofrimit të shërbimeve duke përfshirë në këtë shërbim dhe të anijet që transportojnë mallra të tjera ndaj klientëve si dhe përmirësimin e situatës reale në terren. Në këtë mënyrë do mundësohet shfrytëzimi maksimal i kapaciteteve të portit.

Autoriteti kontraktues, pasi konstatoi se shtesa e propozuar nuk ndryshon kushtet thelbësore të kësaj kontrate, që janë të përcaktuara në dispozitat e kontratës koncesionare dhe që kanë shërbyer si bazë për garën koncesionare dhe për përzgjedhjen e koncesionarit, fituesit, propozon vijimin e procedurës për propozim në Këshill të Ministrave të projektligjit për miratimin e shtesës së kontratës koncesionare.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Shtesa e propozuar në kontratë në tërësi është në përputhje të plotë me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi për koncesionet.

Në bazë të shkronjës “ç”, të pikës 2, të nenit 31, të ligjit nr.125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik/privat” parashikohet mundësia e ndryshimit të kontratave koncesionare në marrëveshje ndërmjet palëve, në rast se përballen me raste që çojnë në ndryshimin e situatës reale për përdorimin e objektit ose në realizimin e kontratës.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Ky projektligj nuk ka për qëllim përafrimin e ndonjë *acquis* të BE-së.

VI. PËRMbledhje SHpjeguese e PËRmbajtjes së PROJEKTAKTIT

Ky projektakt konsiston në miratimin e shtesës së kontratës së koncesionit të formës “BOT” (ndërtim, shfrytëzim dhe transferim), të një porti të llojit MBM në Porto-Romano, Durrës, ndërmjet Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës dhe shoqërisë koncesionare “Porti MBM (multy buoy mooring)” të ndryshuar.

Shtesa e kontratës është e përbërë nga pjesa përsëkruese, si dhe përmban gjithsej 3 nene, e shoqëruar me aneksin 1.1.

Neni 1 i kontratës shtesë bën reflektimin se në fund të pikës 3.1, të nenit 3, “Objekti i koncesionit”, të kontratës së koncesionit të ndryshuar, shtohet fjalia: “Koncesionari mund të ngarkojë shkarkojë dhe përpunojë në këtë port, anije që transportojnë mallra të tjera.”

Neni 2 bën ndryshimin e aneksit 1/1, të kontratës së koncesionit, të ndryshuar me aneksin 1.1. Në këtë aneks janë bërë disa qartësime në përmbajtje si dhe janë pasqyruar rregullime të situatës reale në terren. Te pjesa e dytë është përcaktuar që te koordinatat e paraqitura ndodhet salla e kontrollit të distributorit shpërndarës. Referuar sipërfaqes së operacioneve në tokë për përmirësimin e shërbimeve të kryera në të, janë reflektuar të dhënat përkatëse për sipërfaqen e shfrytëzuar si dhe vendndodhja e kalatave ku do të akostohen dhe përpunohen mjetet lundruese. Në pjesën e tretë dhe të katërt të aneksit 1.1 janë përcaktuar dhe koordinatat gjeografike të argjinaturave përkatëse.

Neni 3 janë dispozitat e fundit që lidhen me hyrjen në fuqi dhe numrin e kopjeve që nënshkruhet kontrata.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Për zbatimin e projektligjit ngarkohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë së bashku me institucionet përkatëse të saj të varësisë.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji është hartuar nga strukturat përgjegjëse të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe është dërguar për mendim në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Ministrinë e Drejtësisë dhe Avokaturën e Shtetit.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Zbatimi i projektligjit nuk shoqërohet me shpenzime shtesë financiare për buxhetin e shtetit.

KËSHILLI I MINISTRAVE